

Thirrje për produksionet e pavarura

Në bazë të nenit 12 të ligjit të RTK-së dhe Rregullores për procedurat dhe kriteret në përzgjedhjen e përmbajtjeve audiovizuale të producentëve të pavarur, **RTK 2 – TV** bën thirrje publike:

Thirrje për aplikim në këto dy kategori programore:

- Programi argëtues-kulturor, dhe/ose
- Programi edukativ për fëmijë

Kriteret për përzgjedhjen e programeve të produksioneve të pavarura:

- Cilësia e skenarit, përmbajtjes, projektit apo programit të regjistruar
- Interesi publik lidhur me përmbajtjen e programit
- Origjinaliteti i ideve
- Çmimi, mënyra dhe kushtet e pagesës
- Shtrirja e të drejtave të cilat jepen
- Referenca e aktorëve, regjisorëve, kameramanëve, skenaristëve, artistëve etj.
- Referenca e producentit të pavarur

Vlera totale për projektin është deri në 11,000 Euro.

Në prezantimin e projektit duhet të specifikohet edhe numri i njësive që ofrohen.

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet në mënyrë elektronike, përmes e-mail adresës: vestirtk2@rtklive.com

Thirrja mbetet e hapur deri më 31.05.2023.